

Me rastin e Asamblesë së tetë të Gjyqtarëve të EULEX-it të mbajtur në Gjilan më 1 qershor 2010

Asambleja e përbërë nga gjyqtarët:

Maria Giuliana Civinini, Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it; Gerrit-Marc Sprenger, Antoinette Lepeltier-Durel, Arkadiusz Sedek, Charles Smith, Dragomir Yordanov, Eija-Liisa Helin, Emilio Gatti, Esma Erterzi, Ferdinando Buatier de Mongeot, Francesco Florit, Gabriele Gaube, Gianfranco Gallo, Guy Van Craen, Hajnalka Karpati, Harri Katara, Laura Plesa, Martti Harsia, Nikolay Entchev, Piero Leanza, Richard Winkelhofer, Riku Jaakkola, Rositza Buzova, Torsten Koschinka, Vergiinia Micheva-Ruseva, Vitor Pardal, Vladimir Kanev, Witold Jakimko.

Miraton VENDIMIN

Me 24 vota për, 2 kundër, 2 abstenime, për aprovimin e këtij Protokollit për organizimin e shqyrtimeve gjyqësore publike në lëndët penale.

Maria Giuliana Civinini

Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

Protokoll

për organizimin e shqyrtimeve gjyqësore publike në lëndët penale

1. Definicionet

- Gjykata : përfshin Gjyqtarët e Gjykatave /Kolegjin/Gjyqtarin e caktuar
- Prokuroria: përfshin të gjithë prokurorët apo zëvendësit ligjorë të tyre

- Avokatët: përfshin të gjithë avokatët anëtarë të Odës së Avokatëve të Kosovës (mbrojtja e të akuzuarve, viktimave, të miturve)
- Shkrimorja: përfshin administratorin e gjykatës, procesmbajtësin dhe stafin e gjykatës
- Palët: të gjithë avokatët e përfshirë, viktimat dhe prokuroria
- Protokollit: marrëveshje detyruese në mes të palëve nënshkruese të protokollit
- Gjykimi: procedura penale para Gjykatës në seancë (shqyrtimet /deklaratat)
- Forcë madhore: rrethana të paparashikuara për t'u interpretuar nga Gjykata në një mënyrë të kufizuar (p.sh. jo kushtet atmosferike/rrugore/të udhëtimit që mund të parashikohen)

2. Përgatitja e shqyrtimit gjyqësor (shkalla e parë).

a – Këshillimi paraprak

Gjykata në procedura gjyqësore komplekse (p.sh. palë të shumta) mund të ftojë të gjitha palët në gjykim (përmes avokatëve të tyre) për këshillim paraprak, për të përcaktuar ditën dhe orën e fillimit të gjykimit dhe për të përcaktuar kohëzgjatjen e gjykimit (shqyrtimit, deklarimit) dhe të caktojë shqyrtimin për viktimat, dëshmitarët ekspertët dhe të akuzuarit.

Pas këtij këshillimi Gjyqtari do të përcaktojë orën dhe ditën e fillimit të shqyrtimit gjyqësor, duke marrë parasysh sa më shumë që është e mundur agjendën e palëve, kohëzgjatjen e paraparë dhe urgjencën e gjykimit, si dhe dispozicionin e sallës së gjykimit dhe stafit të Gjykatës.

Palët, personalisht apo përmes avokatëve të tyre, duhet, sa më parë, t'i sigurojnë Gjykatës listën e dëshmitarëve të tyre dhe kohën e llogaritur për paraqitjen e dëshmimeve mbi të cilat ai/ajo mbështetet.

Palët do të informohen sapo të caktohet data e gjykimit dhe më së paku 8 ditë përpara ditës së fillimit të seancës kryesore, në përputhje me nenin 321 të KPPK-së.

Është detyrë e Gjykatës të sigurojë një proces gjyqësor të drejtë dhe efikas që respekton një proces të drejtë procedural. Gjykata mund të ndryshojë renditjen e paraqitjes së dëshmimeve në interes të efikasitetit dhe kohës së gjykatës, gjithnjë duke pasur parasysh drejtësinë e procedurës.

b – Parandalimi i shtyrjeve të Seancave

Pasi caktohet gjykimi (dita/ora) nuk lejohet shtyrja përveç për arsye të justifikuar. Nëse për ndonjë arsye tjetër avokati apo prokurori i caktuar në lëndë nuk mund të paraqiten në fillim të shqyrtimit gjyqësor apo të seancës, ai/ajo duhet të përfaqësohet nga një zëvendësues ligjor të caktuar paraprakisht nga ana e tij/saj. Njësitë Korrektues dhe/ose njësitë Policor kompetent do të informohen me kohë mbi orarin e gjykimit veçanërisht kur kemi të bëjmë me persona në paraburgim (i akuzuari, dëshmitarët)

c - Qasja e pakufizuar në shkresat e lëndës

Në parim avokatët me të drejtë qasjeje në shkresat penale të gjykimit do të njoftojnë Shkrimoren/Gjykatën, paraprakisht (p.sh. së paku 24 orë përpara me (telefon, e-mail apo me letër...) për t'i siguruar shkresat, përveç në lëndët ku përfshihet paraburgimi. Shkresat e lëndës do të jenë në dispozicion të avokatit në ditën dhe kohën e caktuar.

e - Prioriteti i lëndëve

Duke caktuar gjykimet Gjykata duhet të caktojë së pari gjykimet urgjente, duke marrë parasysh: dosjet dhe lëndët e vjetra që u është afruar koha e parashkrimit, gjykimet ku të pandehurit janë në paraburgim, së dyti gjykimet ku përfshihen viktimat apo dëshmitarët që janë në paraburgim, dëshmitarët me të meta fizike apo mendore, dëshmitarët e moshuar apo të mitur dhe gratë me fëmijë të vegjël. Së fundi lëndët që kanë arritur kohën e parashkrimit apo lëndët që kanë të bëjnë vetëm me çështje procedurale ligjore dhe lëndët në përgjithësi që nuk u duhet seancë gjyqësore e gjatë duhet të caktohen eventualisht të njëjtën ditë sipas orës (p.sh. në orën 9.00 paradite lënda "X" , në orën 10.00 paradite lënda "Z", në orën 11.00 paradite lënda "Y").

f – Garancia për të komunikuar me të akuzuarin

Në parim avokati ka të drejtë të bëjë një bisedë private me klientin e tij të paraburgosur në një dhomë të përshtatshme të Gjykatës deri sa kjo bisedë nuk e vonon fillimin e seancës gjyqësore.

3 Gjykata në seancë.

A- Prezenca me kohë në Gjykatë

Të gjitha palët përfshirë edhe vetë i pandehuri dhe avokati i tij, prokuroria, ekspertët, viktimat dhe dëshmitarët dhe avokatët e tyre duhet të jenë me kohë në gjykatë.

Parimisht, seanca gjyqësore fillon në ora 09:00 - 12:00 (pauza prej 12:00 deri 13:00) dhe eventualisht prej orës 14:00 – 17:30. Kolegji mund të urdhërojë, vetëm për arsye të zbatimit të duhur të drejtësisë, pauza gjatë seancës apo kohë tjetër të fillimit apo vazhdimit.

Gjykata menjëherë duhet t'i njoftojë palët për çfarëdo rrethane e cila shpie në shtyrje, duke njoftuar për ditën e seancës së ardhshme gjyqësore në këtë lëndë.

b-Vonesat e paarsyeshme

Çfarëdo vonese e paarsyeshme, e shkaktuar nga palët, do të konsiderohet si mosrespektim i Gjykatës dhe palëve tjera dhe mund të rezultojë në sanksione eventuale ligjore/disiplinore.

c-Komunikimi Avokat-Klient gjatë Seancës

Gjatë seancës gjyqësore kryetari i trupit gjykues mundet që, me kërkesë të avokatit, t'i lejoj atij që të ketë bisedë private me klientin e tij të paraburgosur (akuzuarin, viktimën apo dëshmitarin) në një dhomë të përshtatshme. Kjo bisedë private nuk duhet të zgjasë më shumë se koha e arsyeshme.

d- Parandalimi i vonesave

Gjykata nuk do t'i lejojë palët të veprojnë në atë mënyrë qëllimi i qartë i të cilit është vonimi i shqyrtimit. Lidhur me këtë palët duhet t'i përmbahen çështjes që trajtohet në gjykim, t'i paraqesin dokumentet e tyre në mënyrë të duhur dhe me kohë (preferohet në version elektronik), t'i shkëmbejnë dokumentet e tyre (paraprakisht) me homologët e tyre në pajtim me kushtet procedurale.

e-Sjellja e palejueshme në Seancë

Palët dhe gjithë personeli në sallën e gjykimit nuk duhet ta pengojnë njëri tjetrin, ndikojnë në çfarëdo mënyre (duke folur apo me shenja) dëshmitarët/ekspertët e dëgjuar nga gjykata në

atë moment, apo të bëjnë komente të papërshtatshme ndaj homologëve të tij/saj apo ndaj vendimit të gjykatës. Telefonat mobil duhet të fiken tërësisht apo së paku t'i "fiket zilha". Në sallë të gjykimit nuk lejohet pirja e duhanit, ngrënia e ushqimit apo pirja përderisa gjykata është në seancë. Gjykata mund të urdhërojë që të shërbehet ujë për viktimat, dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit, palët dhe anëtarët e trupit gjykues.

f- Rregulla të veçanta të Sjelljes në Seancë

Për ta përmirësuar dinjitetin e domosdoshëm të seancave gjyqësore dhe për të promovuar gjykimin e drejtë palët dhe gjithë personeli në sallën e gjykimit duhet:

- të kërkojnë leje nga kryetari i trupit gjykues për të folur, intervenuar, diskutuar apo komunikuar përmes kanaleve tjera,
- të flasin qartë, zëshëm dhe në mënyrë që ndihmon përkthimin simultan,
- të mos iu drejtohen personave të tjerë përveç atyre të përfshirë në atë gjykim të caktuar,
- të mos vishen në mënyrë të papërshtatshme (p.sh jo me pantallona të shkurtër),
- të mos ekspozojnë simbole politike (gjithashtu vlen edhe për gjykatën, shkrimoren, policinë, njësinë korrektuese) në sallë të gjykimit, e as armë, vegla apo mjete tjera që janë apo mund të përdoren si armë (përveç autoriteteve të autorizuarra më herët),
- të inkurajojnë qetësinë në fjalim dhe qëndrim dhe të tregojnë respekt të ndërsjellë ndaj palëve, gjykatës dhe personelit të gjykatës (përfshirë policinë dhe zyrtarët korrektues).

g- Delegimi i zëvendësuesve ligjorë

Palët publike dhe private dhe avokatët e tyre të cilët nuk mund të marrin pjesë në gjykim (përveç forcës madhore) duhet ta njoftojnë gjykatën, eventualisht përmes shkrimores së gjykatës me kohë dhe duhet të sigurohen që ai/ajo është e përfaqësuar nga zëvendësuesi ligjor kështu që procedura gjyqësore normale e planifikuar të mos ndërpritet.

h- Kërkesat për zgjatje të afatit për përgatitje të duhur

Palët do ta njoftojnë gjykatën me kohë kur ata kanë nevojë, kur është në interes të drejtësisë apo në interes të klientit të tyre, për më shumë kohë sesa që është paralajmëruar më parë (p.sh. deklaratat/kundërshtimet) në mënyrë që të sigurohen se gjykata të mund të ofrojë me kohë të gjitha burimet personale dhe materiale.

i-Masat për zgjidhjen e konflikteve

Gjykata do të sigurohet se qetësia dhe rregullat e gjykimit të drejtë do të respektohen rreptësisht dhe prandaj çfarëdo trazimi nga publiku apo palët do të ndalohet menjëherë. Konfliktet eventuale në mes të palëve, në mes të anëtarëve të trupit gjykues, në mes të stafit, në mes të personave të tjerë të përfshirë në gjykim do të raportohen menjëherë tek autoritetet kompetente gjatë dhe pas gjykimit nga ana e Kryetarit të trupit gjykues në mënyrë që të ndërmerren masat e duhura sa më parë që është e mundur.

4. Përfundimi:

- Të gjitha palët në këtë Protokoll do të sigurojnë administrimin e duhur të drejtësisë duke promovuar dhe respektuar kushtet e domosdoshme për mbajtjen e një gjykimi të drejtë në një atmosferë profesionale.

- Të gjitha palët në këtë Protokoll do të ndërmarrin masat e duhura për sigurimin e zbatimit të sjelljeve dhe qëndrimeve të lartpërmendura dhe të pajtohen që të ndërmarrin masat e nevojshme kundër atyre që shkelin rregullat e këtij Protokoll.

- Të gjitha palët në këtë Protokoll do të takohen çdo vit në muajin shtator (me ftesë nga Gjykata) për të vlerësuar zbatimin e Protokollit dhe eventualisht për të ndryshuar dhe/ose për të përmirësuar Protokollin në interes të një gjykimi të drejtë dhe të qetë.